



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
KOMISIONI I SISTEMIT DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 22.11.2023

Formulari Nr.3

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Enti Rregullator i Energjisë
Adresa Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, Tiranë
Tel/Fax 0676321655
E-mail ogjokutaj@ere.gov.al
Faqja e Internetit www.ere.gov.al

Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me objekt: “Blerje 4 (katër) bileta avioni me destinacion Tiranë - Romë - Tiranë dhe 3 (tre) bileta me destinacion Tiranë - Maltë - Tiranë”.

Data e zhvillimit do të jetë **23.11.2023, ora 09:00** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Blerje bileta avioni me destinacion Tiranë – Romë – Tiranë në datat 29.11.2023 – 01.12.2023	4
2	Blerje bileta avioni me destinacion Tiranë – Maltë – Tiranë në datat 04.12.2023 – 06.12.2023	3

1. Biletat e avionit me destinacion Tiranë - Romë - Tiranë, të jenë vajtje – ardhje:

- Nisja nga Tirana për në Romë në datën 29 nëntor, të bëhet pasdite (ora 16:15) fluturim direkt.

- Kthimi nga Roma për në Tiranë në datën 1 dhjetor 2023, të bëhet pasdite (ora 17:00) fluturim direkt.

2. Biletat e avionit me destinacion Tiranë - Maltë - Tiranë, të jenë vajtje – ardhje:

- Nisja nga Tirana për në Maltë në datën 4 dhjetor 2023, të bëhet në mëngjes (ora 04:55) fluturim tranzit nga Vjena.

- Kthimi nga Malta për në Tiranë në datën 6 dhjetor 2023, të bëhet në darkë (ora 18:35) fluturim tranzit nga Roma.

Biletat të jenë të klasit ekonomik, përfshirë dhe bagazhin 20 kg.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentet si më poshtë:

- a- Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar;
- b- Operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar nga International Air Transport Association (IATA). Për të vërtetuar këtë kërkesë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatën e akreditimit ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga International Air Transport Association (IATA), të vlefshme.
- c- Operatori Ekonomik duhet të ketë eksperiencë në këtë fushë, gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e akreditimit IATA 3 (tre) viteve të fundit ose një vërtetim lëshuar nga IATA që deklaron gjendjen e akreditimit për 3 (tre) vitet e fundit.
- d- Operatori ekonomik me anë të një vetë deklarimi, duhet të marrë përsipër se:
 - Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.
 - Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm.

Afati i dorëzimit të dokumentave: do të jetë brenda 2 orëve nga momenti i dërgimit të njoftimit. Operatori i renditur i pari duhet të njoftojë autoritetin kontraktor, brenda 2 orëve mbi pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Në njoftim duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**KRYETARI
PETRIT AHMETI**